

Çfarë është *phishing*?

Mashtruesit përdorin *phishing* për të fituar qasje në të dhënat tuaja personale. Duke përdorur këto të dhëna, mashtruesit mund të marrin paratë nga llogaria juaj apo ta përdorin atë për të kryer vjedhjet e identitetit.

Mashtruesit mund të marrin qasje në të dhënat tuaja duke dërguar mesazhe *phishing*, si dhe përdorimin e teknikave tjera për shembull, *malware*.

Phishing nuk është i kufizuar vetëm në shërbimet bankare përmes internetit, ai bëhet përmes çdo lloji të mundshëm të pagesës.



Çfarë është *malware*?

Malware është një emër kolektiv për të gjitha llojet e softuerit me qëllim të keq dhe të dëmshëm. Në mënyrë të padëshiruar dhe të pa dalluar, ai arrinë të vetinstalohet në kompjuterin tuaj.

Malware ndikon në proceset normale të kompjuterit dhe vjedh informacion nga ai. Në rastin e fundit, ne jemi duke iu referuar si *spyware*.

Mashtruesit përdorin *malware* për të marrë paratë nga llogaria juaj, si dhe për të kryer vjedhjet e identitetit.



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale



Agjencia Shtetërore për
Mbrojtjen e të Dhënave
Personale

Rr. LUAN HARADINAJ - P.N.
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës

www.amdp-rks.org




<https://fb.com/586985264766778>



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data



Vjedhja e Identitetit



www.amdp-rks.org

Çka është vjedhja e identitetit?

Mashtrulesit përdorin vjedhjen e identitetit për të marrë përsipër identitetin tuaj dhe për të pretenduar që jeni ju. Vjedhja e identitetit mund të bëhet në të gjitha aspektet e jetës së përditshme, madje edhe kur jeni duke përdorur shëbimet e bankës përmes internetit apo edhe kryerjen e pagesave përmes tij. Shembull, mashtrulesit mund të hapin një llogari bankare në emrin tuaj, në të cilën ata depozitojnë të hollat e fituara përmes mashtrimit ose mund të bëjnë blerje me kredit kartelë në emrin tuaj.

Si punon një kriminel ?

Për të ju vjedhur identitetin, mashtrulesit përdorin të dhënat tuaja personale të cilat i marrin përmes metodave si *phishing*, *malware*, apo ndonjë metodë tjetër të inxhinierisë sociale.

Mashtrulesit mund të i marrin të dhënat tuaja në mënyra të ndryshme, dhe jo vetëm nëpërmjet internetit apo kompjuterit: ata gjithashtu mund të bëjnë një kërkesë në bankë për zëvendësimin e kodit me arsyen se "ju ka humbur kodi i vjetër". Kur banka dërgon këtë në adresën tuaj, mashtrulesi vjedh atë nga kutia juaj postare. Kjo mund të jetë veçanërisht e rrezikshme në ndërtesat e banimit (apartamente), sepse të gjitha kutitë e postës zakonisht janë të vendosura në hyrje të ndërtesës dhe dryri i tyre mund të thyhet shumë lehtë.


Disa informata mashtrulesit i marrin shumë lehtë përmes rrjeteve sociale. Prandaj ju duhet të jeni gjithmonë të kujdesshëm se çka publikoni.

Çfarë bën banka juaj ?

Zakonisht vjedhjen e identitetit tuaj mashtrulesit e bëjnë me ndihmën tuaj, por që ju nuk jeni në dijeni, duke përdorur *phishing*, malware dhe metoda tjera të inxhinierisë sociale. Gjithmonë jeni të kujdesshëm dhe informohuni se çka është duke bërë banka juaj për të ju mbrojtur prej tyre.

Një mashtrules, megjithatë, mundet të punojë krejtësisht pa "ndihmën tuaj", duke e prezentuar veten e tij si ju. Për të shmangur këtë, banka juaj gjithmonë vepron si në vijim:

- Kur bëni hapjen e llogarisë, banka ju kërkon prova (letërnjoftimin në shumicën e rasteve) të vlefshme të identitetit dhe gjithashtu e kontrollon nëse ky dokument ka qenë i raportuar si i vjedhur apo humbur. Si një klient i ri, ju gjithmonë duhet të nënshkruani me letërnjoftimin tuaj;
- Bankat dërgojnë masat e sigurisë dhe kodet (p.sh. PIN kodin apo fjalëkalimin), veç e veç ose ju kërkojnë që ju të shkoni personalisht për të i marrë ato. Shembull, kartën e debitit e merrni personalisht, ndërsa PIN-in ju a dërgojnë me postë apo e dorëzojnë në pliko.
- Bankat u dërgojnë mesazhe konfirmimi klientëve të tyre çdoherë që informatat personale ndryshohen.



Çfarë mund të bëni?

Është një numër i çështjeve që ju mund të i kushtoni vëmendje në mënyrë që të shmangni vjedhjen e identitetit:

- Të jeni të kujdesshëm me gjërat të cilat vërtetojnë identitetin tuaj;
- Raportoni menjëherë humbjen apo vjedhjen e vërtetuesve të identitetit në polici;
- Sigurohuni që kutia juaj postare është e sigurtë dhe nuk mund të zbrazet nga jashtë;
- Sigurohuni se dikush nuk do të zbrazë kutinë tuaj postare kur ju nuk jeni në shtëpi për periudha të gjata;
- Njofto bankën tuaj në qoftë se një kod i sigurisë nuk arrinë brenda periudhës së zakonshme ;
- Menjëherë raportoni humbjen apo vjedhjen e kodeve dhe fjalëkalimeve;
- Rregullisht kontrolloni të dhënat tuaja personale dhe transaksionet në llogarinë tuaj;
- Kini kujdes me informacionin që ju e publikoni në faqet e internetit dhe rrjetet sociale;
- Njoftoni bankën tuaj, nëse shihni transaksione të çuditshme në llogarinë tuaj, ose gabime në të dhënat tuaja personale;

Gjithmonë vëzhgoni për *phishing*, *malware*. Këto janë teknika të cilat mashtrulesit i përdorin për të kryer vjedhjen e identitetit.